



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit
04 Nr.189
Më:24/07/2018

Bazuar në nenin 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 46 i Statutit të Komunës së Gjakovës i dt.26.12.2008, Drejtoria e Arsimit në Gjakovë lëshon këtë:

V E N D I M

- 1.Anulohet konkursi zyrtar 04/181 i dt.20/07/2018 të shkollës “Ukshin Miftari” në Skivjan për pozitën Një (1) mësimdhënës/e mbështetëse.
- 2.Obligohet menaxhmenti i kësaj drejtorie të shpall konkursin të ri në shkollën “Ukshin Miftari” në Skivjan sipas Marrëveshjes Partneriteti me Save The Children International në Kosovë dhe Drejtorinë e Arsimit si dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjakovë për pozitën e një (1) edukatore me bazë në komunitet brenda kësaj shkolle.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin nga Drejtori i Arsimit në Gjakovë.

A R S Y E T I M

Marrja e këtij vendimi nga ana e Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë bëhet me qëllim që konkursi zyrtar 04/181 i dt.20/07/2018 të shpallur nga ana e Drejtorisë së Arsimit në partneritet me Save The Children të anulohet dhe i njëjti të hapet për pozitën e edukatores ashtu siç është e paraparë edhe në marrëveshjen e partneritetit në mes të Save The Children International në Kosovë dhe Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale në Gjakovë.

I dorëzohet: Save The Children International në Kosovë, Shërbimit Juridik dhe Arkivës.

Drejtori i DKA-së
Mr.Sc.Bernard Firokaj

